



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 3001/2 prot.,

Datë 04.12.2023

**FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR**

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr.REF-86642-11-07-2023, me objekt: “*Blerje Hipoklorit Natriumi për kërkesat e Shoqërisë Rajonale UK Sarandë* ” me fond limit 5 600 000 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 21.11.2023 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Sarandë SH.A.
- Ankimues:** “Albania Distribution Chemicals” SHPK, me NUIS M11815028I, me adresë: Rr. Rruga e Kavajes, Buka SH.A, Nr.8240, Njesia Nr.6, Tirane
- Autoriteti Kontraktor:** Shoqëria Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Sarandë SH.A me adresë: Qafë-Gjashtë, Sarandë, Rruga “Skënderbeu”

Në datën 03.12.2023, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 3001/2023 protokolli dhe me numër ankimi elektronik A/2023/3664 e operatorit ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr.REF-86642-11-07-2023, me objekt: “*Blerje Hipoklorit Natriumi për kërkesat e Shoqërisë Rajonale UK Sarandë* ” me fond

limit 5 600 000 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 21.11.2023 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Sarandë SH.A.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Albania Distribution Chemicals” SHPK.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:

b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”, Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik ankimues “Albania Distribution Chemicals” SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. 3001 prot.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyet e skualifikimit si më poshtë vijon:

Arsyet e skualifikimit:

Mungojne dokumentat e meposhtem:

1. Bilanci dhe xhiro vjetore e vitit 2020

2. Fleta e analizes se treguesve kimik jashte afatit kohor prej 3 muajve te fundit

3. Certifikata e transportit per mallra te rrezikshme.”

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 04.12.2023.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri